



A.nr.50/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktar, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj - Demi, anëtarë, me Hava Fekaj në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 50/2026, të datës 16.01.2026 të parashtruar nga ankuesja F.K, të cilën e përfaqëson me autorizimin avokatja Albana Kelmendi, kundër organit të punësimit Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike *“masë disiplinore”*, në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A .nr. 50/2026, e datës 16.01.2026 e parashtruar nga ankuesja F.K, ashtu që ndryshohet Vendimi Nr.03/2025 i datës 17.12.2025, i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, lidhur me cilësimin e shkeljeve disiplinore dhe masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankueses, duke zëvendësuar masën disiplinore *“ndalimi i 20% të pagës bazë për një periudhë prej 4 muaj”*, në masën disiplinore *“Ndalim i 20% të pagës bazë për një periudhë prej 2 muaj”*.

II. Obligohet Udhëheqësi i Njësisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja F.K, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja) me datë 16.01.2026, ka parashtruar ankesë, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar me datë 16.01.2026, e regjistruar me shenjen A.nr.50/2026, me të cilën e kundërshton Vendimin Nr.03/2025 të datës 17.12.2025 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të të drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 21.01.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ndërsa kjo e fundit, më datë 28.01.2026 ka përcjellë shkresat e lëndës lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 50/2026, të datës 16.01.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës, të datës 16.01.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.01.2026; Autorizimi i datës 04.12.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses F.K; Vendim me numër Nr.03/2025, i datës 17.12.2025; Vendim i KPMSHCK-së me A.nr.563/2025 dhe numër protokolli Nr.4231/2025, i datës 20.06.2025; Njoftim me Email i datës 24.12.2025; Njoftim me Email i datës 16.10.2025; Vendim me numër protokolli Nr.02/63-5177/2025, i datës 06.10.2025; Raport i Komisionit me numër protokolli Nr.04-03-5177/2025-2, i datës 09.10.2025; Vendim me numër protokolli Nr.02-63-5177/2025-3, i datës 09.10.2025; Kërkesë me E-mali me korrespondim prej 7 faqeve, i datës 16.10.2025; Email me prova me korrespondim prej 11 faqeve, i datës 05.12.2025; Email, i datës 08.10.2025; Email i datës 15.10.2025; Kërkesë me Email me korrespondim prej 7 faqeve, i datës 16.10.2025; Kërkesë me e-mail i datës 01.07.2025; Vendim me numër protokolli Nr.02-11-6254/2025, i datës 26.11.2025; Njoftim me Email me korrespondim prej 3 faqeve, i datës 18.09.2025; Vendim me numër protokolli Nr.02-70-6246/2025/02, i datës 26.11.2025; Email i datës 05.02.2024; Njoftim me Email me korrespondim prej 4 faqeve i datës 18.09.2025; Email me korrespondim prej 6 faqeve i datës 08.10.2025; Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore me numër protokolli Nr.05-95-5323/2025-02, i datës 13.10.2025; E-mail me korrespondim prej 6 faqeve i datës 08.10.2025; Email i datës 08.10.2025; Email i datës 24.09.2025; Njoftim me Email me korrespondim prej 4 faqeve, i datës 18.09.2025; Vendim me numër protokolli Nr.02-63-5177/2025-3, i datës 09.10.2025; Kërkesë me Email me korrespondim prej 4 faqeve i datës 18.09.2025; Njoftim me Email i datës 18.09.2025; Kërkesë me E-mail me korrespondim prej 5 faqeve, i datës 17.09.2025; Njoftim me Email me korrespondim prej 7 faqeve, i datës 01.07.2025; Ankesë me Email me korrespondim prej 6 faqeve i datës 01.07.2025; Raport me E-mail i datës 25.06.2025; Kërkesë me Email me korrespondim prej 7 faqeve, i datës 01.07.2025; Ankesë me E-mail me korrespondim prej 6 faqeve, e datës 01.07.2025; Njoftim me Email i datës 15.09.2025; Njoftim me Email i datës 12.09.2025; Njoftim me Email me korrespondim prej 5 faqeve, i datës 15.09.2025; Email i datës 15.10.2025; Përgjigje në ankesë e datës 28.01.2026, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit me numër

protokolli Nr.5122/2019, i datës 05.12.2019; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit me numër protokoll Nr.148/2015, i datës 01.01.2015; Përshkrimi i detyrave të punës me numër protokoll Nr.1030/13/2013, i datës 26.03.2013; Vendim me numër protokoll Nr.02-11-6776/2025, i datës 17.12.2025; Procesverbal i datës 29.01.2025; Procesverbal i datës 29.10.2025; Procesverbal i datës 11.11.2025; Procesverbal i datës 03.12.2025; Procesverbal i datës 05.12.2025; Akt emërim me numër protokoll Nr.5352/2014, i datës 29.12.2024; Përshkrimi i detyrave të punës me numër protokoll Nr.1030/3/2013, i datës 26.03.2013; Kërkesë nëpërmjet Emailit të datës 15.10.2025; Njoftim për Inicimin e procedurës disiplinore me numër protokoll Nr.02-11-5323/2025-2-2, i datës 15.10.2025; Ftesë nëpërmjet Email e datës 03.12.2025; Ftesë nëpërmjet Emailit të datës 27.10.2025; Ftesë me Email i datës 27.10.2025; Ftesë me Email i datës 10.11.2025; Vendim me numër protokoll Nr.02-11-6053/2025, i datës 18.11.2025; Vendim me numër protokoll Nr.02-03-5444/2025, i datës 20.10.2025; Akt emërimi me numër protokoll Nr.1772/2012/01, i datës 21.06.2012; Vendim përmes emailit të 17.12.2025; Formular i vlerësimit të rezultateve të punës me numër protokoll Nr.05-95-490/2025/16-120, i datës 18.02.2025; Email me korrespondim 37 faqeve, i datës 05.12.2025; Email me korrespondim prej 3 faqeve, i datës 08.10.2025; Njoftim me Email i datës 12.09.2025; Raport me Email i datës 25.06.2025; Kërkesë me E-mail me korrespondim prej 9 faqeve, i datës 01.06.2025; Kërkesë me E-mail me korrespondim prej 5 faqeve, i datës 17.09.2025; Email me korrespondim prej 3 faqeve, i datës 15.10.2025; Njoftim me Email i datës 15.09.2025; Kërkesë me E-mail me korrespondim prej 7 faqeve, i datës 01.07.2025; Ankesë me Email me korrespondim prej 6 faqeve, i datës 01.07.2025; Email me korrespondim prej 4 faqeve, i datës 08.10.2025; Email me korrespondim prej 5 faqeve, i datës 08.10.2025; Kërkesë me Email me korrespondim prej 11 faqeve, e datës 19.09.2025; Njoftim me E-mail i datës 18.09.2025; Kërkesë me Email me korrespondim prej 7 faqeve, e datës 01.07.2025; Kërkesë me Email e datës 02.07.2025; Ankesë me Email me korrespondim prej 6 faqeve, e datës 27.06.2025; Deklaratë me Email e datës 25.06.2025; Kërkesë me Email me korrespondim prej 6 faqeve, e datës 19.06.2025; Email me korrespondim prej 3 faqeve, i datës 07.06.2023; Email i datës 05.06.2023; Email i datës 27.10.2023; Email i datës 01.11.2023; Email me korrespondim prej 4 faqeve, i datës 02.02.2024; Email i datës 10.11.2025; Email me korrespondim prej 7 faqeve, i datës 19.06.2025; Email i datës 11.09.2025; Email i datës 18.09.2025; Ankesë me Email me korrespondim prej 5 faqeve, i datës 19.06.2025; Kërkesë me Email me korrespondim, prej 10 faqeve i datës 19.09.2025; Kërkesë me Email e datës 11.09.2025; Email me korrespondim, prej 4 faqeve, i datës 19.09.2025; Email i datës 10.11.2025; Email me korrespondim, prej 4 faqeve, i datës 19.06.2025.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë pjesërisht të bazuara pretendimet ankimore të ankueses, *sepse*:

Nga administrimi i provave materiale rezulton: Ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe se e njëjta sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit me numër protokoll 5122/2019 të datës 05.12.2019, ushtron pozitën, Zyrtare për Promovim të Edukimit Jo formal - Departamenti i Rinisë.

Udhëheqësi i Divizionit për Edukim Jo Formal, Promovim dhe Punësim, në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit më datë 13.10.2025, ka parashtruar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses në Komisionin Disiplinor për shkak të supozimeve se “...ankuesja ka shkelur rregullat e përcaktuara me kodin e etikës, sjelljen e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil dhe përsëritje të shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë, sepse znj D.G dhe F.K kanë pasur komunikimet të cilat nuk janë përmirësuar edhe pas shumë komunikimeve dhe tentimeve për të parandaluar sjelljen e pa përshtatshme, duke theksuar se ka kryer shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.6, 4.7 dhe 4.11 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Komisioni Disiplinor i MKRS-së, më Vendimin Nr.03/2025, të datës 17.12.2025, ka shpall ankuesen përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.6, 4.7 dhe 4.11 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, *gjegjesisht shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë, duke i shqiptuar masën disiplinore “ndalimi i 20% të pagës bazë për një periudhë prej 4 muaj”.*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshton Vendimin me nr.03/2025 të datës 17.12.2025, të Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Duke pretenduar se i është mohuar e drejta për njohje me dosjen e lëndës, Vendimi i atakuar përmban mungesë të arsytimit të plotë dhe të vërtetimit të fakteve konkrete, tutje ka shtuar se Vendimi me nr.03/2025 të datës 17.12.2025, ka mungesë të individualizmit të fakteve dhe lidhjes se provave me konstatimin për dëmtim të reputacionit të shërbimit civil, po ashtu edhe komisioni nuk i ka shqyrtuar provat vendimtare të paraqitura nga ankuesja. Ankuesja nëpërmjet përfaqësues kërkon që të aprovet ankesa dhe të anulohet vendim i kontestuar me ankesë.

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen ankimore, iu referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

- Nenit 55 paragrafi 1: “Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.

- Neni 56, paragrafi 1 dhe 4: “Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhenca e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja;

4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civilë; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.

- Nenit 57 paragrafi 2: “Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të rënda janë: **2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”.**

-Neni 58 1.Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe/apo nga udhëheqësja/i më i lartë administrativ. 2.Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor.

Neni 59: 1.Procedura disiplinore fillon mbi bazën e dyshimit të bazuar për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil, duke mos përjashtuar informatat e pranuar në mënyrë anonime. 2. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil. 3. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 3.1. me kërkesë të mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë të nëpunëses/it civil; 3.2. bazuar në të gjeturat dhe/apo rekomandimet e çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtareje/i tjetër brenda institucionit, si dhe me kërkesën e qytetares/it; 3.3. me nismën e çdo anëtare/i të komisionit, mbi bazën e dyshimit të bazuar për kryerjen e një shkeljeje disiplinore. 4. Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësja/i civil, ndaj të cilës/it ka filluar një procedurë disiplinore pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së saj/tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e përkohshëm të nëpunëses/it civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Vendimi për pezullim sipas këtij paragrafi, është veprim i

ndërmjetëm procedural ndaj të cilit nuk lejohet ankesa. 5. Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunëses/it për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedurës, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike, të drejtën për t'u asistuar, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. 6. Nëpunësja/i civil mund të ndihmohet gjatë procedurave disiplinore nga një përfaqësuese/es i sindikatës ku bën pjesë, nga një përfaqësuese/es ligjor apo nga një përfaqësuese e nëpunëseve/ëve civil të institucionit. 7. Procedura disiplinore fillon pa vonesë, me vënien në dijeni për një shkelje disiplinore, por jo më vonë se brenda afatit dy (2) vjeçar nga data e kryerjes së shkeljes. Në rastin e shkeljeve të rënda, afati është pesë (5) vjet. 8. Masat disiplinore regjistrohen në dosjen individuale të nëpunëses/it, me përjashtim të vërejtjes verbale. 9. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton: 9.1. procedurën disiplinore, në përputhje me Ligjin përkatës për Procedurën Administrative; 9.2. Kodin e Etikës për nëpunësen/in civil.

-Neni 6: 1. Për përcaktimin e masës disiplinore mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 62 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunëses/it për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore shqiptohen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet e lehta, shqiptohen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 57 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e rënda, shqiptohen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 2. të nenit 57 të këtij ligji. 5. Për çdo shkelje shqiptohet vetëm një masë disiplinore.

Referuar kuadrit ligjor të cekur si më lartë, e në mbështetje të nenit 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit ka analizuar vendimin e kundërshtuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje administrative, ku si rrjedhojë, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor bazuar në dëshmitë e zyrtarëve Xh.B dhe V.J si dhe provave materiale të ofruara nga palët në procedurë ka vërtetuar së ankuesja në mënyrë të vazhdueshme ka pas komunikime ofenduese dhe jo profesionale me zyrtaren D.G, ka treguar sjellja të papërshtatshme në komunikimet e saj gjatë ushtrimit të detyrave të punës, sjelljet e saj përfshijnë ofendime të koleges D.G, dhe së ankuesja përkundër vërejtjeve të vazhdueshme verbale të dhëna nga udhëheqësi i saj ishte paralajmëruar për mos përsëritje të sjelljeve dhe komunikimeve të tilla.

Rrjedhimisht, nga provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, Kolegji ka gjetur komunikime me shkrim të ankueses në raport me zyrtaret udhëheqës të cilat komunikime i referohen raporteve të ankueses me zyrtaren F.K më të cilin qëndrojnë në të njëjtën një zyrë, e të cilat komunikime në vlerësimin e Kolegjit pasqyrojnë një komunikim dhe sjelle jo zyrtare dhe të papërshtatshme të ankueses si zyrtare publike. Ndërsa, nga deklaratimet e zyrtareve përkatëse të dhëna pranë Komisionit Disiplinore, Kolegji verën se:

-Xh.B, në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Rinisë, në deklaratën e datës 29.10.2025, pohon se:
..Unë si Drejtori iu Departamentet disa herë kam komunikuar dhe kam shikuar në zyrë me i qëtesu dhe me arrit një pajtueshmëri. Ndërkohë prapë kanë lind konfliktet dhe nuk kam mundur ton kohën me qenë aty si polic me i rujt së po ndodhë në zyrë , se kërrussh nuk mundet kërkon më kontrollu ne zyre...Zyret janë publike dhe shtetërori, edhe kurrkush nuk mundet më qenë mbi ligjin.... Kam than me përpara me ju shkru dhe më marr masa se me i ndrru zyret,..ja une jam munduar në anën njerëzore,, ma shumë në mëngjes si jam ardh mu marr këto sende, jo e hapi dritaren jo e lëshoj klimën. Janë veprime të ulëta...Unë ju kam kërkuar dy udhëheqëseve ose le ti zgjidhin ose le te shkojnë diku tjetër...Ja kam tërheq vërejtjen një mirë herë. I kam thirrë në zyrë.. kam fol edhe në aspektin familjar pasi që janë gra të martuara, kanë fëmijë janë nana që të dyja...edhe B.-Sekretari i kam tregu..... na e dimë se kur te del punë edhe me E, dije që diçka nuk je ne rregull ti diçka, se E. është që 24 vjet në ministri...nuk mundet me tha dikush që ka e ka ofendu, ajo ka kulture, është e formuar... është tepër e çdo sene..

-V.J, Udhëheqës i Divizionit për Politika Zhvillimore të Rinisë, në deklaratën e datës 11.11.2025, ka deklaruar.. D. po besoj tash e një vit ka dal prej zyrës sonë dhe u zhvendos në zyrën 003 me kolegen F.K.. Fillimisht kane kaluar mirë, mirëpo tash e disa muaj konfliktit mes D. dhe F. është përshkallëzuar. Ka pas shkëmbime të emailave, korrespondenca duke akuzuar njëra tjetrën. Edhe ne kemi bere përpjekje gjithmonë me bere një zgjedhje, me ju fol mire por nuk kemi mundur. Pasta,j kjo pune ka eskalu. Po besoj qe edhe dëshmitë qe i keni se paku dy video qe ju muni mi vlerësu vet të cilat i ka dërguar F. .. Tash unë nuk po du me ja ba avokatin kurrkujt po kolegja F...është person së nxit shumë situata, që shtyn me reagua, e ka një fare qasje te ngacmon me senet e pa qena. .. ka ndodhë qe kane dal tre kolege pasi e kane pas të pamundur me vepru për shkak te F..D ka momente qe tregon shenja nervoze.. sjellje jo te përshtatshme qofte edhe me kolege, qoftë edhe me palë te çilat ne a e din që cdo herë kemi munduar me inicim procedure,.. .. unë vite me parë i kamë dhënë vërejtkeje D. po ajo ka skedua/ ..Kjo është nënë me fëmije dhe jeni munduar me kuptua gjendjen emocionale te saj,..

Kolegji i Këshillit thekson faktin së zyrtarët publikë janë të obliguar të respektojnë njëri tjetrin në vendin e punës, të bashkëpunojnë mes tyre, në rast të pakënaqësive dhe mospajtimeve që shfaqen gjatë ushtrimit të detyrave të punës të diskutojnë në rrugë profesionale dhe të ndërgjegjshme, nëpunësit civilë duhet të kenë kujdes të mos i pengojnë nëpunësit civil tjerë në kryerjen e detyrave të rregullta të punë dhe marrëdhëniet ndërmjet nëpunësve civil bazohen në respektin e ndërsjellë, si dhe në ruajtjen e dinjitetit dhe personalitetit të nëpunësit civil ashtu siç përcaktohen me nenin 10 dhe 12 të Kodit të Etikes së Nëpunësve Civil (Rregullore (QRK) - Nr.04/2015 për Kodin e mirësjelljes në shërbimin civil të Republikës së Kosovës). Ne fakt, çdo sjellje dhe veprim jashtë këtyre parimeve dhe normave bien ndesh me Kodin e Etikes së Zyrtarit Publik dhe së si të tilla përbejnë shkelje disiplinore që i nënshtrohet ndëshkimeve administrative të përcaktuara me dispozita ligjore materiale.

Lidhur me pretendimin ankimor se nuk i është mundësia ankueses për njohje me dosjen e lëndës, Kolegji nga provat e lëndës konstaton së një pretendim i tillë nuk ka mbështetje ligjore sepse pala ankuese është njoftuar më kohë më inicimin e procedurës disiplinore dhe po ashtu i është dhënë mundësia e dëgjimit dhe e deponimit të fakteve dhe provave në kuptim të argumentit të mbrojtjes dhe shfajësimit.

Andaj, referuar të gjeturave dhe konstatimeve si më sipër, Kolegji vie në përfundim së Komisioni Disiplinor i MKRS-së ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike lidhur me konstatimin e përgjegjësisë individuale disiplinore të ankueses, sepse, siç u konfirmua më lartë, komunikimi dhe sjelljet e përdoruar nga ankuesja në raport me zyrtaren D.G, janë në kundërshtim me Kodin e Etikes, ankuesja në mënyrë të vazhdueshëm ishte paralajmëruar verbalisht nga stafi mbikëqyrës për qasjen dhe sjelljen e saj të papërshtatshme, mirëpo, në vlerësimin e Kolegjit, Komisioni Disiplinor gabimisht ka bërë cilësimin e shkeljeve disiplinore të ankueses duke e shpallur të njëjtën përgjegjës edhe për shkelje të rëndë disiplinore *sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil*; sepse, sipas kolegjit veprimet dhe sjelljet e ankueses nuk kanë të bëjmë me publikun gjegjësisht jashtë institucionit e të cilat veprime do të kishin pasoja për imazhin e shërbimit civil dhe institucionit përkatës.

Referuar sqarimeve dhe të gjeturave të pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe 132, paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, aprovoj ankesën pjesërisht si të bazuar, duke aprovuar si të bazuar pretendimin ankimor së Komisioni Disiplinor nuk ka argumentuar së ankuesja ka bërë shkelje disiplinore për sjellje të papërshtatshme të ankueses që dëmton reputacionin e shërbimit civil, ndërsa refuzohen pretendimet tjera si në ankesë dhe si rrjedhojë ndryshohet Vendimin Nr.03/2025, i datës 17.12.2025, i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, lidhur me cilësimin e shkeljeve disiplinore dhe masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankueses, duke zëvendësuar masat disiplinore “*ndalimi i 20% të pagës bazë për një periudhë prej 4 muaj*”, në masën disiplinore “*Ndalim i 20% të pagës bazë për një periudhë prej 2 muaj*”.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër: A.nr.50/2026

Hava Fekaj

Procesmbajtës

Malsore Gashi-Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së autorizuar të ankueses avokates Albana Kelmendi;
- Njesisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.